

RELACION
MBI PROJEKTLIGJIN
“PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10091, DATË 05.03.2009, ‘PËR
AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR
DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR’, I NDRYSHUAR”**

**I. QËLLIMI I PROJEKT-AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Ministria e Financave (MF) po drejton zbatimin e reformës së përmirësimit të raportimit financiar në përputhje me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare, me mbështetjen e Bankës Botërore (BB), duke përmirësuar kornizën ligjore, me qëllim rritjen e cilësisë së raportimit financiar në vend. Kjo reformë mbështetet në tre shtylla kryesore, të cilat kanë të bëjnë me:

1. Përmirësimin e kuadrit institucional të palëve të përfshira në reformë;

Në këtë kuadër, janë realizuar një sërë ndryshimesh ligjore në fushën e raportimit financiar dhe auditimit ligjor, me qëllim kryesor miratimin e një kuadri të shëndoshë të raportimit financiar të përshtatur për nevojat e ekonomisë shqiptare dhe të harmonizuar me *acquis communautaire* të BE-së si dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në kuadër të prioritetëve të reformës, në fokus është përditësimi i vazhdueshëm i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe në këtë kontekst është krijuar dhe mbështetur forcimi i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, me qëllim kryesor përmbushjen e kërkesave rregullatore dhe përgatitjen e standardeve për profesionin e kontabilistit.

Po kështu, është krijuar sistemi i mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese duke patur si qëllim që të rrisë sigurinë, që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik.

2. Konsolidimin e kapacitetit institucional për të zbatuar *acquis communautaire* të fushës së raportimit financiar;

Në këtë kontekst, përveç aktorëve kryesorë të tillë si KKK, BMP, organizatat profesionale të kontabilistëve dhe audituesve ligjorë, janë mbështetur edhe rregullatorë të tjerë të tillë si Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, lidhur me krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të trajnimit dhe edukimit mbi zbatimin dhe imponimin e zbatimit të standardeve të kontabilitetit dhe auditimit. Gjithashtu, në këtë kuadër është mbështetur administrata tatimore lidhur me përdorimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe përdorimi i tyre në raportimin fiskal. Qendra Kombëtare e Biznesit gjithashtu, ka zhvilluar një sistem efikas të

regjistrimit dhe publikimit të pasqyrave financiare të njësive ekonomike, në përputhje me pjesët përkatëse të *acquis communautaire*.

Në kuadër të reformës, mbështetje e veçantë është dhënë edhe për organizatën profesionale të audituesve ligjore (IEKA) me qëllim shndërrimin e saj në një organ profesional kompetent për kryerjen e detyrave të tij, si subjekt i mbikëqyrjes publike, në funksion të përmirësimit të cilësisë së auditimit ligjor dhe mbrojtjes së interesit publik.

Organizatrat profesionale të kontabilitetit janë mbështetur në zhvillimin dhe zbatimin e proceseve dhe procedurave të përmirësuara të strukturuar, që do të lejojnë realizimin e veprimtarisë së tyre në mënyrë efektive, efikase dhe në përputhje me praktikatat e mira ndërkombëtare. Objektivi është rregullimi i duhur i profesionit të kontabilistit, pa dëmtuar konkurrencën, përveç sigurimit të mbrojtjes së palëve të treta që marrin shërbime nga një kontabilist.

Një rol të rëndësishëm në fushën e raportimit financiar luajnë dhe Institucionet e Arsimit të Lartë. Në këtë kontekst, këto institucione janë mbështetur për të përmirësuar modulet dhe programet mësimore lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontabilitetit, me qëllimin përfundimtar përmirësimit të cilësisë së të diplomuarve në këto fusha.

3. Rritjen e ndërgjegjësimit mbi raportimin financiar dhe auditimin ligjor në vend.

Në këtë drejtim janë ndërmarrë një sërë aktiviteteve lidhur me ndërgjegjësimin publik mbi ekonominë informale dhe përfitimet e përmirësimit të cilësisë së kontabilitetit dhe auditimit ligjor.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së kapaciteteve të industrisë së kontabilitetit nëpërmjet gjenerimit të të ardhurave nga burime të reja, duke krijuar një mjedis më të mirë për prodhimin e raportimit financiar me cilësi të lartë në përgjithësi.

Sa më sipër, duke patur si qëllim kryesor përmirësimin e cilësisë së auditimit ligjor dhe përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator të fushës së kontabilitetit dhe auditimit të vendit tonë me praktikatat më të mira, si dhe përafrimin e mëtejshëm me direktivat dhe rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian (BE), MF ka iniciuar ndërmarrjen e aktiviteteve në kuadër të ndryshimit të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar, të ndryshuar”. Lidhur me përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator të fushës me *acquis communautaire*, realizimi i ndryshimeve të këtij ligji i përgjigjet kërkesave të paraqitura në Kapitullin 6 “Legjislacioni tregtar” të raportit të progresit të BE për vendin tonë, si dhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (2024–2026), të cilat kërkojnë harmonizimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për kontabilitetin, transparencën dhe auditimin ligjor me *acquis* më të fundit të BE-së në këto fusha; dhe forcimin e kapaciteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) për sa i përket burimeve njerëzore dhe financimit të këtij institucioni.

Gjithashtu, rishikimi i këtij ligji mbështet angazhimin e qeverisë shqiptare për përmbushjen e masave të ndërmarra në kuadër të kërkesave që ka dokumenti i BB mbi Huanë e Politikave Zhvillimore (DPL), i cili mbështetet në 3 shtylla kryesore. Një nga shtyllat kryesore të këtij dokumenti ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit dhe duke qenë se ndryshimet e propozuara në ligj

lidhen edhe me dhënien e sigurisë mbi raportimin e qëndrueshmërisë të hartuar nga njësitë ekonomike përkatëse në vendin tonë, këto ndryshime do të japin kontribut në rritjen e ndërgjegjësimit ndaj çështjeve jofinanciare, si ato mjedisore, sociale, korrupsionin, etj.

Mbi sa më sipër, në tërësi, projekt-ligji synon të arrijë këto objektiva:

- Përafrimin e legjislacionit me atë të BE, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e përcaktuara në Kapitullin 6 të *acquis communautaire*;
- Përcaktim më të qartë të njësive që janë të detyruara të kryejnë auditimin ligjor;
- Përmirësimin e implementimit të mëtejshëm të ligjit, duke përmirësuar dhe forcuar rregullat për kryerjen e auditimit ligjor të njësive me interes publik (NJEIP);
- Përcaktimi i detyrimit për dhënien e sigurisë mbi raportimin e qëndrueshmërisë nga shoqëritë e auditimit;
- Qartësim më të plotë në lidhje me realizimin e disa procedurave bazë të punës që duhet të kryhen nga audituesit ligjorë, në mbështetje të përcaktimeve që ka dhe direktiva përkatëse; si dhe
- Qartësimin e terminologjive përkatëse ku janë hasur problematika, me synim unifikimin dhe përmirësimin e zbatueshmërisë së këtij ligji.

Realizimi i këtyre objektivave, në kuadër të ndryshimeve përkatëse, do të bëjë të mundur rritjen e cilësisë dhe përgjegjshmërisë së audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, duke forcuar qeverisjen e brendshme të njësive ekonomike me interes publik, përmirësuar punën e audituesve ligjorë, duke krijuar në këtë mënyrë një treg më profesional dhe transparent të auditimit ligjor. Në të njëjtën kohë, raportimi financiar i shëndoshë dhe transparent luan një rol kyç në rritjen e besimit të investitorëve të brendshëm dhe të huaj, si një kriter i rëndësishëm për inkurajimin e investimeve, inovacionit dhe rritjes ekonomike në vend. Një kuadër ligjor konciz dhe i fortë, i shoqëruar nga profesione të forta të kontabilitetit dhe auditimit ligjor do të çojë në rritjen e besimit të investitorëve dhe publikut.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NE RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Bazuar në Programin e Qeverisë 2021-2025, një ndër angazhimet kryesore është anëtarësimi në BE. Në këtë kontekst, duhet të zbatohet me korrektësi Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), pjesë e të cilit është edhe Kapitulli 6 i *acquis communautaire* “Legjislacioni tregtar”, në të cilin përfshihet edhe detyrimi i harmonizimit të rregullave për përgatitjen e pasqyrave dhe raportimit financiar.

Ndryshimet e propozuara janë në përputhje me programin e Qeverisë dhe me legjislacionin e BE-së në këtë fushë.

Projekt-ligji nuk është i parashikuar në planin analitik të projektakteve të MF për vitin 2024, por ishte i parashikuar për t’u miratuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

III. ARGUMENTIM I PROJEKT-AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Duke patur si qëllim kryesor përmirësimin e profesionit të audituesit ligjor si dhe përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator të fushës së kontabilitetit dhe auditimit të vendit tonë me praktikat më të mira si dhe direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE, si dhe në mbështetje të problematikave të evidentuara në çështjet e organizimit të punës së audituesit ligjor për njësitë ekonomike, veçanërisht për njësitë ekonomike me interes publik, ndryshimet kryesore të ligjit lidhen me këto fusha kryesore:

- Përditësimin e kriterëve të njësive ekonomike që janë të detyruara të kryejnë auditimin ligjor në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin.. Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:
 - a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik;
 - b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:
 - i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
 - ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
 - iii. ka, mesatarisht, të paktën 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël.
- Gjithashtu, të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare përkatësisht si njësi ekonomike dhe grupe të njësive ekonomike të vogla dhe të mesme mund të kryejnë auditimin nëpërmjet audituesve ligjorë apo shoqërive audituese. Të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike të klasifikuara të mëdha dhe NJEIP, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, detyrohen ta kryejnë auditimin vetëm nëpërmjet shoqërive audituese. Për shoqëritë audituese që angazhohen në auditimin e njësive ekonomike të mëdha dhe NJEIP do të përcaktohen kriteret shtesë me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Një element i rëndësishëm që vjen si risi, mbështetur në direktivat e BE në lidhje me auditimin ligjor dhe të kontabilitetit të sektorit privat, është përfshirja e detyrimit ligjor për audituesit ligjorë të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë (sipas direktivës përkatëse të kontabilitetit, raporti do të përgatitet nga njësitë ekonomike të mëdha, duke hyrë në fuqi gradualisht deri në vitin 2028). Aktualisht, një raportim i tillë në vendin tonë është përfshirë pjesërisht në ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe përgatitet nga njësitë përkatëse, pavarësisht se ka vend për përmirësim të mëtejshëm. Gjithashtu, bazuar në analizat e kryera në lidhje me njësitë që duhet të përgatisin këtë raport, rezulton se janë rreth 50 njësi të tilla, prej të cilave shumica e përgatisin aktualisht, duke qenë pjesë e grupeve ekonomike të mëdha dhe që kërkojnë një raportim të tillë. Pra, kostoja e këtij raportimi nuk është relevante për ato njësi të cilat do të detyrohen ta përgatisin bazuar në ligjin e kontabilitetit, i cili në bashkëpunim me BB pritet të ndryshohet gjatë vitit 2025.
- Qartësimin e procesit dhe koncepteve të lidhura me auditimin ligjor të NJEIP, bazuar në rregulloren e BE (përf forcimi i funksioneve të komitetit të auditimit, përcaktimi i detyrimit të kryerjes së rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit, raportimi ndaj komitetit të auditimit, etj.).

- Qartësim më i plotë në lidhje me realizimin e disa procedurave bazë të punës që duhet të kryhen nga audituesit ligjorë, në mbështetje të përcaktimeve që ka dhe direktiva përkatëse. Kryesisht, shtesat kanë të bëjnë me përcaktimin e rregullave bazë të auditimit që lidhen me kohën e angazhimit të auditimit, me mbajtjen e regjistrave përkatës si për shkeljet e kryera dhe për çdo klient të audituesit, mbajtjen e një dosje auditimi për çdo auditim ligjor dhe dosje për çdo angazhim në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë si dhe regjistrimin nga ana e audituesit të çdo ankese të ardhur ndaj tij në lidhje me angazhimet në raportimin e qëndrueshmërisë.
- Gjithashtu, në kuadër të qartësimit më të madh dhe përmirësimit të problematikave të evidentuara më parë në lidhje me zbatueshmërinë e ligjit aktual, ndryshime të vogla janë realizuar dhe në disa aspekte të përshtatura me kontekstin lokal si: në procesin e kontrollit të cilësisë, në qartësimin më të madh të roleve dhe funksioneve të institucioneve rregullatore të kësaj fushë, në rritjen e zbatueshmërisë së standardeve të auditimit si dhe në qartësimin e sistemit të masave sanksionuese (një detajim dhe qartësim i masave - të shprehura në % të qarkullimit vjetor, është përcaktuar sanksionimi i organeve drejtuese të NJEIP (në përputhje me rregulloren përkatëse të BE, element i cili mungon në ligjin aktual), është qartësuar procesi i publikimit të masave, raportimi i shkeljeve si dhe është bërë një përcaktim më i qartë i përgjegjësiave administrative të strukturave të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, në rast shkeljeve nga ana e tyre).

Projekt-ligji i propozuar për auditimin ligjor do të ndikojë pozitivisht duke kontribuar në përmirësimin e kuadrit ligjor të auditimit. Përfitimet kryesore janë si më poshtë:

- Rritje e transparencës dhe llogaridhënies nga të gjithë aktorët e përfshirë në auditimin ligjor;
- Cilësia e përmirësuar e auditimeve;
- Forcimin e mëtejshëm të zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit, që do të sjellë harmonizimin e mëtejshëm të këtij ligji me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Kjo lehtëson investimet ndërkufitare dhe rrit besueshmërinë e pasqyrave financiare të përgatitura nga subjektet në vend;
- Përcaktimi i kuadrit në lidhje me masat sanksionuese dhe disiplinore në funksion të ruajtjes së integritetit të profesionit të auditimit. Nëpërmjet këtyre dispozitave synohet të adresohen problematikat aktuale të marrjes së masave disiplinore dhe sanksionuese, duke përcaktuar korniza të qarta në lidhje me marrjen e këtyre masave ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese që zbatojnë kërkesat e kuadrit rregullator dhe standardeve përkatëse profesionale gjatë punës së tyre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt-ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 ‘Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar’, i ndryshuar”, është i mbështetur në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Direktivën 2006/43/EC, të ndryshuar;

- Rregulloren EU nr. 537/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 16 Prill 2014, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNATUAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE)

Projekt-ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar”, përaftron pjesërisht Direktivën 2006/43/EC të ndryshuar si dhe Rregulloren e EU nr. 537/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 16 Prill 2014, të ndryshuar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT

Ky projektligj ka në përbërje të tij 32 nene, sqarimet e të cilave jepen si më poshtë:

1. Në nenin 1, tek pika 2 është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
2. Në nenin 2 ndryshojnë pikat si më poshtë:
 - Pika 1 - lidhur me përkufizimin për termin “Auditim ligjor”, për tu përshtatur me direktivën.
 - Pika 2 - lidhur me përkufizimin për termin “Auditues ligjor i huaj” për tu përshtatur me direktivën dhe është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
 - Pika 3 - lidhur me përkufizimin për termin “Auditues i grupit” për tu përshtatur me direktivën dhe është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
 - Pika 4 - lidhur me përkufizimin për termin “Komision i provimeve të aftësive profesionale”, sqarim i mëtejshëm.
 - Pika 7 - lidhur me përkufizimin për termin “Auditues ligjor” për t’u përshtatur me direktivën dhe është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
 - Pika 8 - është përmirësuar përkufizimi i termit “Kandidat”.
 - Pika 9 - është përmirësuar përkufizimi i termit “Kontabilist i miratuar”
 - Pika 12 - është sqaruar germa c dhe është shtuar pika 12/1 për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
 - Pika 14 - është ndryshuar termi “Auditim ligjor” për tu përshtatur me direktivën.
 - Pika 17 - është përmirësuar përkufizimi “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë” (SNMC) për tu përshtatur me terminologjinë lidhur me standardet e miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë (BSNAS) si dhe është shtuar pjesa mbi limitin kohor brenda të cilit këto standarde duhen publikuar, nga data e publikimit nga ana e BSNAS.
 - Pika 20 - është ndryshuar përkufizimi “Shoqëri auditimi” dhe është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, për t’u përshtatur me direktivën.

Pika 21 - është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, për t'u përshtatur me direktivën.

Pika 23 - është përmirësuar përkufizimi i termit “Njësi ekonomike me interes publik” duke integruar në grup edhe shoqëritë komisionere dhe institucionet e tregut.

Pika 23/1 është shtuar për tu përshtatur me direktivën.

Pika 23/2 është shtuar për tu përshtatur me direktivën.

Pika 24 është shtuar si përafrim me direktivën.

3. Në nenin 3 ndryshon:

Pika 1 - është përmirësuar përkufizimi i BMP, me qëllim qartësimin e statusit dhe selinë e tij, si edhe është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, për t'u përshtatur me direktivën.

Pika 2 - është përmirësuar përkufizimi mbi kriteret e përfshirjes në strukturën mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, për t'u përshtatur me direktivën.

4. Në nenin 4/1 ndryshon:

Pika 1- është përmirësuar përkufizimi mbi financimin e BMP. Konsolidimi i të ardhurave të BMP do të ndikojë në ruajtjen e integritetit të kuadrit ligjor dhe rregullator të auditimit, duke garantuar një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt për palët e treta.

5. Në nenin 5 ndryshon:

Pika 1 - lidhur me të drejtat dhe detyrat e BMP, ku janë shtuar germat i, j, k dhe l mbi detyrat e bordit, duke rritur transparencën dhe përmirësuar raportimin e tij.

6. Në nenin 7 ndryshojnë pikat si më poshtë:

Pika 1 - lidhur me organizimin e audituesve ligjorë dhe i shoqërive audituese, ku është përmirësuar përkufizimi.

Pika 3 - sqarohet mënyra e miratimit të statutit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, i cili miratohet nga Ministri i Financave, pas marrjes së mendimit nga BMP.

7. Në nenin 12 ndryshon:

Pika 2 - lidhur me kompetencat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë është përmirësuar përkufizimi dhe shtuar shkronja ç) dhe g), për t'u përshtatur me direktivën.

8. Në nenin 15 ndryshon:

Pikat 1 dhe 2 -shtohet përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, për t'u përshtatur me direktivën, si edhe përmirësohet përkufizimi ku kërkohet që praktika profesionale të jetë e lidhur edhe me qëndrueshmërinë.

Pika 7 - shfuqizohet.

9. Në nenin 18 ndryshon:

Shtohet Pika 6/1 – mbi garancinë që duhet të japin provimet e aftësive profesionale në lidhje me njohuritë teorike dhe praktike të nevojshme për dhënien e sigurisë së raportimit të qëndrueshmërisë, sipas direktivës.

Pika 10 - përmirësohet përkufizimi për t'u përshtatur me direktivën.

10. Në nenin 24 ndryshon:

Shtohet Pika 4 - mbi përcaktimin e përkufizimit të reputacionit të mirë.

11. Në nenin 28 shtohen shkronjat a/1) dhe e) dhe ndryshon shkronja c) ku përmirësohet përkufizimi mbi regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shtohet përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, sipas direktivës.

12. Në nenin 29 përmirësohen shkronjat d) dhe f) ku shtohet përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe shtohet shkronja h) për t'u përshtatur me direktivën. Si edhe shtohet Pika 2: - mbi rregullat dhe procedurat për regjistrimin dhe përditësimin e informacionit në regjistrin publik për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, sipas direktivës.
13. Në nenin 32 ndryshon:
- Pika 1 - lidhur me parimet e etikës profesionale dhe papajtueshmëritë, sipas direktivës si dhe përcaktohet afati kohor për përkthimin dhe publikimin e ndryshimeve të standardeve ndërkombëtare të etikës të Profesionistëve Kontabël.
14. Shtohet neni 32/1 mbi skepticizmin profesional gjatë kryerjes së një auditimi, sipas direktivës.
15. Në nenin 33 ndryshojnë pikat si më poshtë:
- Pika 1 - është përmirësuar përkufizimi lidhur me pavarësinë gjatë auditimit ligjor. Shtohet Pika 1/1 - ku sqarohet më gjerë se si audituesi ligjor duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar pavarësinë e tij, sipas direktivës.
- Pika 4 - është përmirësuar përkufizimi lidhur me konfliktin e interesit të audituesit ligjor ose shoqërisë së auditimit, për t'u përshtatur me direktivën.
- Shtohet Pika 4/2 - ku sqarohen rastet e interesave të përfitimit material apo instrumenteve financiare të lëshuara, garantuara apo të mbështetura nga njësi ekonomike e audituar, sipas direktivës.
- Pika 6 - është ndryshuar përkufizimi mbi dokumentimin e kërcënimeve/presioneve gjatë auditimit dhe janë listuar kërcënimet që mund të konsiderohen të rëndësishme, sipas direktivës.
- Shtohen Pikat 6.2), 6.3), 6.4), 6.5) dhe 6.6): - ku sqarohen më gjerësisht rastet e zotërimit të instrumente financiarë apo interesave ekonomike nga ana e audituesit ligjor apo shoqërisë së auditimit në njësinë ekonomike të audituar, rastet e marrëdhënieve të ndryshme (pune, biznesi etj.), dhuratave e favoreve, në mënyrë që të evitohet konflikti i interesit, sipas direktivës.
- Pika 7 - është përmirësuar përkufizimi dhe është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, sipas direktivës.
- Shtohet Pika 7/1: - mbi rolin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike në lidhje me vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë së audituesit ligjor dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë për një njësi ekonomike me interes publik, sipas direktivës.
16. Në nenin 36 ndryshojnë pikat si më poshtë:
- Pika 1 - është përmirësuar përkufizimi lidhur me rregullat e auditimit dhe ortakun kryesor të qëndrueshmërisë, për t'u përshtatur me direktivën.
- Pika 2 - është përmirësuar përkufizimi lidhur me mjaftueshmërinë e kohës dhe burimeve për kryerjen e auditimit, sipas direktivës.
- Pika 3 - lidhur me krijimin e një regjistri mbi shkeljet e dispozitave të këtij ligji, sipas direktivës.
- Pika 4 - lidhur me krijimin e një regjistri të klientit të auditimit, sipas direktivës.
- Pika 5 - lidhur me krijimin e një dosje auditimi, sipas direktivës.
- Pika 6 - lidhur me regjistrimin e ankesave kundrejt auditimeve të realizuara, sipas direktivës.

Pika 7 - lidhur me të drejtën e BMP që të kërkojë çdo informacion nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese mbi mënyrën se si i përmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor.

17. Në nenin 37 sqarohet fushëveprimi i auditimit ligjor si dhe saktësohet që rezultatet e raportimit të sigurimit të qëndrueshmërisë paraqiten në një raport sigurie në përputhje me standardet.
18. Në nenin 38 janë qartësuar disa procese pune në lidhje me sistemin e dhënies së sigurisë, mbështetur në direktivë.
19. Në nenin 39 janë qartësuar përcaktimet në lidhje me procedurën e kontrollit të cilësisë së realizuar nga BMP, sipas kërkesave të direktivës dhe rregullores së BE si dhe është shtuar përkufizimi për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, për t'u përshtatur me direktivën.
20. Neni 41 ndryshon në lidhje me përcaktimet se kush e kryen auditimin ligjor, sipas përcaktimeve të pragjeve të përcaktuara për qëllime të raportimit financiar.
21. Në nenin 42 përmirësohet përkufizimi në lidhje me emërimin e audituesve ligjorë ose shoqërive audituese, ndalohen klauzolat kontraktuale që kufizojnë emërimet e bëra nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve/ortakëve, përcaktohet termi kohor mbi zëvendësimin e audituesit ligjor të së njëjtës njësi ekonomike, sipas direktivës dhe rregullores, sqarohet termi kohor për zëvendësimin e audituesit ligjor përgjegjës për kryerjen e angazhimit të auditimit të së njëjtës njësi ekonomike si dhe vendosen masat sanksionuese me të cilat përballen audituesit dhe shoqëritë e auditimit si dhe organi administrativ ose drejtues i një njësie ekonomike me interes publik, në rast të mos zbatimit të dispozitave të këtij neni.
22. Në nenin 46 jepet informacion mbi komitetin e auditimit të NJEIP, si zgjidhet ai dhe detyrat e tij në mënyrë që të rritet kontrolli i cilësisë së angazhimit.
23. Shtohet neni 46/1 mbi rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit dhe sqarohen mënyrat se si do bëhet ky rishikim, si do dokumentohen të dhënat dhe si do vlerësohen elementët e ndryshëm, sipas direktivës dhe rregullores.
24. Në nenin 54 është përmirësuar përkufizimi mbi fushën e zbatimit të kreut VIII të këtij projekt-ligji duke shtuar në përkufizim edhe organizatën profesionale të audituesve ligjorë.
25. Neni 55 ndryshon në lidhje me shkeljet dhe masat disiplinore. Përcakton autoritetin që ka të drejtë të marrë masa ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, afatet e përfundimit të procedurave të investigimit, si dhe sanksionet në varësi të shkeljeve sipas rastit.
26. Shtohet neni 55/1 mbi publikimin e masave sanksionuese. Përcaktohen mënyrat dhe afatet e publikimit të këtyre masave.
Shtohet neni 55/2 mbi përgjegjësinë administrative për strukturat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Përcaktohen shkeljet administrative dhe disiplinore për të cilat jepen sanksione administrative si dhe masat sanksionuese.
27. Neni 57/1 ndryshon në lidhje me të drejtën e ankimit në gjykatën administrative kompetente në vendin ku ka selinë BMP.
28. Shtohet neni 57/3 në lidhje me rishikimin e vendimit të BMP në rast se pala ankimuese ka siguruar prova të reja.
29. Neni 58 - shfuqizohet.

30. Në nenin 59 jepet informacion shtesë mbi disa kërkesa, përjashtime, terma kohorë dhe mbi edukimin e vazhdueshëm profesional që audituesit ligjorë të regjistruar apo që kanë fituar titullin “Auditues Ligjor” në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji duhen të ndjekin në mënyrë që të aftësohen në lidhje me dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë.
31. Në nenin 60 saktësohet hartimi i akteve nënligjore nga ana e Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe nga Këshilli i Ministrave.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT

Ky ligj zbatohet nga të gjithë audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit, si dhe kontabilistët e miratuar. Ligji rregullon auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara, organizimin e profesionit të audituesit ligjor, të shoqërive të auditimit, të kontabilistit të miratuar, si dhe rregullimin e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe të organizatës profesionale të audituesve ligjorë si dhe të autoritetit mbikëqyrës.

Për këtë arsye, për zbatimin e këtij ligji ngarkohen gjithashtu të gjitha organizatat profesionale në fushën e kontabilitetit, organizata profesionale e audituesve ligjorë si dhe të autoritetit mbikëqyrës (BMP). Gjithashtu, për zbatimin e këtij ligji ngarkohen edhe të gjitha entitetet ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të këtij ligji, janë të detyruara të auditojnë pasqyrat e tyre financiare vjetore dhe të konsoliduara.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT DHE QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Kontribut në hartimin e projekt-ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 ‘Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar’ i ndryshuar”, ka dhënë Banka Botërore, nëpërmjet rekomandimeve dhe komenteve të dhëna gjatë të gjitha fazave të hartimit të këtij projekt-ligji si dhe palët e interesit gjatë takimeve paraprake të realizuara. Projekt-ligji është dërguar për mendim pranë audituesve ligjorë (IEKA), Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shtetit dhe Kryenegociatorit, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Bankës së Shqipërisë, Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Komentet e ardhura nga këto institucione janë argumentuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

Në lidhje me mendimet nga Ministria e Drejtësisë dërguar nëpërmjet shkresës me datë 19.07.2024 japim sqarimet si më poshtë:

1. Përsa i përket përkufizimit të dhënë në pikën 2, nenin 1 të projektligjit, ju informojmë se ky përkufizim është në përputhje me përkufizimin e këtij termi në Direktivën e BE në lidhje me fushën e auditimit ligjor. Ky togfjalësh “apo ku është e zbatueshme”, është përdorur për të bërë një lloj ndarjeje ndërmjet dhënies së sigurisë nga ana e audituesve ligjorë mbi pasqyrat financiare vjetore si dhe dhënies së sigurisë në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë, në ato raste kur ky raport hartohet nga njësitë ekonomike përkatëse.

Njësitë që hartojnë këtë raport përcaktohen në legjislacionin përkatës mbi kontabilitetin në sektorin privat.

2. Në lidhje me komentin mbi vendosjen e gjobave nga ana e organizatave profesionale, sqarojmë se në nenin 14 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar”, pika 1 përcakton se “*Organizata profesionale e audituesve ligjorë vë në funksionim një sistem efikas investigimi dhe monitorimi të disiplinës, si dhe respekton procedurat e kryerjes së investigimit, me qëllim zbulimin, korrigjimin dhe parandalimin e mangësive, që mund të vërehen gjatë kryerjes së shërbimit të auditimit ligjor dhe të shërbimeve profesionale të tjera dhe të lidhura nga audituesit ligjorë*”. Gjithashtu, neni 13, pika c) përcakton si burim të ardhurash për organizatën profesionale “*shumat e arkëtuara për gjokat dhe penalitetet e vendosura ndaj anëtarëve të tij, në rast të shkeljeve disiplinore*; “. Ndërkohë, në lidhje me gjokat e vendosura si pasojë e këtyre proceseve të investigimit, rregullorja nr. 1 datë 26.07.2017 “Për mbledhjen e të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, e ndryshuar, neni 5, pika 5 përcakton se “*Në mbështetje të nenit 4/1 pika 4 të ligjit për auditimin BMP ka të drejtë të arkëtojë në dhe për llogari të tij 30% të të ardhurave nga gjokat që organizatat profesionale e audituesve ligjorë dhe organizatat e kontabilistëve të miratuar kanë vendosur ndaj anëtarëve të tyre . Arkëtimi do të bëhet brenda 30 ditëve nga arkëtimi i gjobës nga vetë organizata*”. Gjithashtu, theksojmë se kjo pikë përfshin dhe rastet kur: (i) organizata profesionale e audituesve ligjorë, pas kryerjes së procesit të investigimit nga ana e tyre, propozon pranë BMP marrjen e masave përkatëse ndaj audituesve ligjorë; (ii) dhe rastin kur organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar marrin masa në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në statutin dhe rregulloret përkatëse të tyre.
3. Në lidhje me nxjerrjen e akteve rregullatore nga ana e BMP, ju sqarojmë se Bordi i Mbikëqyrjes Publike është autoritet rregullator i pavarur me qëllim realizimin e mbikëqyrjes publike të profesionit të auditimit dhe shoqërive të auditimit, si drejtpërdrejtë, ashtu edhe nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë. BMP është gjithashtu autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e profesionit të kontabilistëve të miratuar dhe organizatave profesionale përkatëse. Misioni kryesor i BMP është rritja e sigurisë se auditimet kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar, të kujdesshëm dhe në shërbim të interesit të publikut, bazuar në kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare. Pavarësia e këtij organi shfaqet në disa forma: pavarësi funksionale në marrjen e vendimeve dhe rregullimin e çdo aspekti të lidhur me profesionin e audituesit ligjor, pavarësi financiare në mbledhjen dhe destinimin e të ardhurave të krijuara nga burimet e financimit të ndryshme nga buxheti i shtetit dhe pavarësia organizative sipas të cilës Bordit i është njohur e drejta për miratimin e strukturës së tij organizative. Për rrjedhojë, vlerësojmë se duke qenë se në tërësinë e tij, fryma e këtij projekt-ligji garanton pavarësinë e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, ky autoritet ka të drejtën e nxjerrjes së akteve rregullatore që rregullojnë fushën e auditimit ligjor. Gjithashtu, sipas përcaktimeve të ligjit të auditimit ligjor, BMP ka të drejtën e nxjerrjes së rregulloreve përkatëse, bazuar në detyrat dhe të drejtat e tij (neni 4 i ligjit), për të rregulluar funksionimin e fushave të ndryshme që i përkasin auditimit ligjor.
4. Sugjerimi përsa i përket pikës 1 dhe 2 të nenit 5 të këtij projektligji është reflektuar.
5. Përsa i përket shpjegimit të togfjalëshit “jo me interes publik”, sqarojmë se klasifikimi me interes apo jo me interes publik është një klasifikim i njësive ekonomike për efekt procesi

- të raportimit financiar si dhe të auditimit ligjor të tyre. Ky është një koncept ekzistues në ligjin e auditimit ligjor, ku pika 23, neni 2 përcakton: *“Njësi ekonomike me interes publik” janë: a) të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë; b) bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë; c) shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar; ç) shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”* Këto njësi që quhen të tilla sipas pikës ç) janë përcaktuar nëpërmjet Vendimit nr. 17, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”,* i ndryshuar. Pjesa tjetër e njësisë ekonomike, të cilat nuk plotësojnë kushtet e përkufizimit të ligjit si dhe të VKM-së quhen njësi ekonomike jo me interes publik.
6. Në lidhje me përcaktimin e termit “reputacion i mirë”, ky koncept është në përputhje me Direktivën e BE, ndërkohë rastet kur jemi në kushtet e reputacionit të mirë, janë përcaktuar duke u bazuar në praktikat më të mira dhe rastet praktike, pa u shprehur në mënyrë shteruese. Sugjerimi në lidhje me përdorimin e fjalës “mund”, u reflektua.
 7. Përsa i përket përkufizimit “skeptizëm profesional”, ky është një term i njohur dhe i përdorur në fushën e auditimit ligjor, i cili përkufizohet në standardet ndërkombëtare të auditimit si dhe në Kodin e Etikës së profesionistëve kontabël, tërësisht të zbatueshme sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, ky nen është në përputhje të plotë me përkufizimin e dhënë në Direktivën përkatëse të BE. Ndërkohë, sugjerimi në lidhje me pikën 2 të këtij neni u reflektua.
 8. Përsa i përket pikës 1 dhe 2 të nenit 10 të projektligjit, të cilat janë çështje teknike të lidhura me procesin e auditimit ligjor, janë paraqitur rastet e kërcënimit të konfliktit të interesit mes palëve të përfshira, llojet e kërcënimeve si dhe dokumentimin e tyre, të cilat janë në përputhje të plotë me Direktivën e BE. Në projektligj janë përcaktuar disa elementë bazë në lidhje me konfliktin e interesit, por më në detaje gjenden dhe në standardet e auditimit si dhe në Kodin e Etikës së profesionistëve kontabël. Sugjerimi në lidhje me pikën 3 të projektligjit u reflektua.
 9. Në lidhje me sugjerimin mbi përdorimin e termit “kohë e mjaftueshme”, përcaktimet në këtë nen janë në përputhshmëri të plotë me Direktivën e BE, duke përdorur të njëjtin term “kohë e mjaftueshme”. Kjo për faktin se çdo angazhim auditimi, në varësi të kompleksitetit, ngarkesës, problematikave që mund të ketë kërkon burime njerëzore, financiare dhe kohore të ndryshme, ndaj audituesi bën një vlerësim paraprak të nevojave që ai ka para se të marrë përsipër një angazhim të caktuar. Gjithashtu, vlen të theksohet se në vlerësimin e treguesve kohorë të punës për auditimin ligjor, organizata profesionale e audituesve ligjorë përcakton orët minimale të punës për kryerjen e angazhimit të auditimit ligjor, të cilat ia paraqet BMP.
 10. Sugjerimi në lidhje me nenin 12 të projektligjit u reflektua.
 11. Në lidhje me përcaktimin e afateve mbi procedurat e sigurimit të cilësisë, ju sqarojmë se këto afate të lidhura me raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë, si një nga elementët kryesorë të mekanizmit të mbikëqyrjes nga ana e BMP, janë në përputhje të

plotë me praktikat më të mirat ndërkombëtare, konkretisht me pikën 8 të nenit 26 në Rregulloren e BE mbi auditimin ligjor nr. 537/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e ndryshuar, si dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit 18 të Rregullores të BMP nr. 7, datë 02.10.2018 “Për Procedurat, metodologjinë dhe organizimin e Kontrollit të Cilësisë së Auditimit Ligjor”, e ndryshuar.

12. Sugjerimi në lidhje pikën 1 të nenit 15 të projektligjit u reflektua.
13. Në lidhje me sugjerimin mbi Komitetin e Auditimit, ju sqarojmë që përcaktimet në lidhje me këtë komitet, në pikën 2 të nenit 17 janë në përputhje me nenin 39 të Direktivës së BE të auditimit ligjor. Komiteti i auditimit është një strukturë që ngrihet dhe funksionon në disa institucione specifike, kryesisht rregullatorë të fushave të ndryshme dhe kryen detyra që përcaktohen në akte ligjore të ndryshme, që i përkasin këtyre fushave. Ndërkohë, në këtë pikë janë evidentuar ato detyra që ky komitet ka përsa i përket fushës së raportimit financiar apo auditimit ligjor dhe proceseve që lidhen me këto fusha, ndaj dhe është përdorur togfjalëshi “ndër të tjera”, i përdorur edhe në direktivë. Gjithashtu, përsa i përket germës d), ju sqarojmë që ashtu si edhe është shprehur në projektligj, kontrolli dhe monitorimi i pavarësisë së shoqërive audituese realizohet në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës, por specifikisht do të realizohet në lidhje me çështjen e ofrimit të shërbimeve jo audituese, element i cili përcaktohet në përputhje të plotë me nenin 5 të Rregullores 537/2014 së BE. Përsa i përket pjesës së raportimit të Komiteti i Auditimit, në përputhje me nenin 39 të direktivës dhe detyrimin për zbatim të kërkesave përkatëse që lidhen me çështjet që duhet të raportohen në Komitetin e auditimit, të përcaktuara në rregulloren 537/2014, shoqëritë audituese që angazhohen në auditimin e njësive ekonomike me interes publik, hartojnë një raport për gjetjet kryesore, që kanë impakt në njësinë ekonomike, përveç raportit të auditimit. Sipas këtyre kërkesave shoqëritë e auditimit hartojnë një raport shtesë, që përmban rezultatet e auditimit në lidhje me pavarësinë, audituesin ligjor që ka nënshkruar raportin e auditimit në emër të shoqërisë audituese, përshkrim të komunikimit me komitetin e auditimit përgjatë kryerjes së angazhimit, fushëveprimin dhe kohën e kryerjes së angazhimit, metodologjinë e përdorur gjatë auditimit, nivelin e materialitetit të zbatuar, mangësitë e rëndësishme në sistemin e raportimit financiar të identifikuar dhe nëse këto mangësi janë adresuar nga drejtimi i njësisë, përdorimin e parimit të vijimësisë nga njësia ekonomike, vështirësitë në sigurimin e informacionit për qëllimin e auditimit etj., kërkesa që do të përcaktohen aktet rregullatore që do të hartohen në zbatim të kësaj dispozite.
14. Në lidhje me sugjerimin mbi rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit, ju sqarojmë se ky nen është në përputhshmëri të plotë me nenin 8 të Rregullores së BE të auditimit ligjor, i cili dhe nëpërmjet këtij neni identifikohen detyrat dhe çështjet kryesore të procesit të auditimit të cilat duhet të jenë subjekt rishikimi nga rishikuesi i kontrollit të cilësisë së angazhimit. Kërkesat e kësaj dispozite janë në përputhje të plotë me kërkesat përkatëse të standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë dhe standardit ndërkombëtar të auditimit 220, për menaxhimin e cilësisë së angazhimit të auditimit, të cilat përcaktojnë elementët që duhet të përmbajë raporti i rishikuesit të kontrollit të cilësisë, por pa vendosur kufizime në çështje të tjera të auditimit të cilat janë objekt i raportit të rishikuesit të kontrollit të cilësisë së auditimit, në funksion të sigurimit të cilësisë së angazhimit, si një

hallkë e rëndësishme e sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë që duhet të sigurohet nga shoqëria audituese dhe audituesi ligjor.

15. Përsa i përket sugjerimit në lidhje me sanksionet që ndërmerren nga BMP, ju sqarojmë ky nen është hartuar në mbështetje të nenit 30 të Direktivës së BE në lidhje me fushën e auditimit ligjor. Në pikën 2 të këtij neni janë përcaktuar llojet e sanksioneve të zbatueshme në përputhje me rastet e parashikuara në rast të mos zbatimit të kërkesave përkatëse të ligjit, sipas parashikimeve të paraqitura në pikat 3-5. Këto masa sanksionuese do të garantojnë zbatimin proporcional në përputhje me shkeljet e konstatuara, të cilat do të detajohen nëpërmjet rregulloreve përkatëse, që do të hartohen nga BMP në zbatim të pikës 6 të këtij neni.
16. Në lidhje me sugjerimin mbi publikimin e rezultatit të ankimimit, ju sqarojmë se pika 2 e këtij neni është në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 30c të Direktivës së BE të auditimit ligjor, e cila përcakton se: *“Kur shtetet anëtare lejojnë publikimin e sanksioneve që janë objekt ankimimi, autoritetet kompetente do të publikojnë gjithashtu në faqen e tyre zyrtare të internetit, sa më shpejt dhe në mënyrë të arsyeshme që të jetë e mundur, informacionin në lidhje me statusin dhe rezultatin e çdo apelimi”*.
17. Sugjerimi në lidhje me nenin 21 të projektligjit është reflektuar.
18. Në lidhje me sugjerimin mbi lehtësimin e procedurave të ofruara, ju sqarojmë se ndryshimet e këtij ligji vijnë si rrjedhojë e masave që duhet të ndërmarrë MF për përputhshmërinë e regjimeve rregullatore vendase në angazhimet e tregtisë së shërbimeve sipas Protokollit Shtesë 6 (AP6) të CEFTA-s. Gjithashtu, këto rregullime janë në përputhje dhe me Kapitullin 3 të progres-raportit të BE “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”, e cila përfshin aktivitetet tregtare dhe harmonizon rregullat në lidhje me profesionet e rregulluara për të siguruar njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve dhe diplomave midis Shteteve Anëtare.
19. Sugjerimi në lidhje me përdorimin e lidhëzës dhe/ose është reflektuar, për aq sa është e mundur në këtë projektligj.
20. Sugjerimi në lidhje me ripunimin e relacionit shoqërues është reflektuar.

Në lidhje me mendimet nga Ministri i Shtetit dhe Kryengociatori dërguar nëpërmjet shkresës nr. 3339/1, datë 21.06.2024 japim sqarimet si më poshtë:

1. Sugjerimet në lidhje me formatimin dhe përgatitjen e tabelave të përputhshmërisë, në të dyja gjuhët janë reflektuar.

Në lidhje me mendimet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dërguar nëpërmjet shkresës datë 28.06.2024 japim sqarimet si më poshtë:

1. Sugjerimi në lidhje me përcaktimin e njësive ekonomike që duhet të kryejnë auditimin ligjor, duke përfshirë shoqëritë me interes publik, është reflektuar.

Në lidhje me mendimet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dërguar nëpërmjet shkresës nr.1655/1, datë 26.06.2024 japim sqarimet si më poshtë:

1. Sugjerimet në lidhje me qartësimin e përkufizimit të njësive ekonomike me interes publik si dhe në lidhje me komitetin e auditimit janë reflektuar.

Në lidhje me mendimet nga Banka e Shqipërisë dërguar nëpërmjet shkresës nr. 2638/1, datë 15.07.2024 japim sqarimet si më poshtë:

1. Sugjerimi në lidhje me unifikimin e termit “kërcënime/presione të konsiderueshme/rëndësishme” është reflektuar.
2. Sugjerimet për sa i përket teknikës legjislative janë reflektuar në bazë të komenteve të dhëna nga strukturat kompetente për këtë fushë.
3. Mbi sugjerimet në lidhje me çështjet teknike të fushës si emërimi i audituesit ligjor dhe komitetit të auditimit, ju sqarojmë se propozimet në lidhje me këto fusha janë në përputhje me direktivën/rregulloren e BE në këtë fushë.

Në lidhje me mendimet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dërguar nëpërmjet shkresës në datë 04.07.2024 si dhe bazuar në takimin konsultativ, japim sqarimet si më poshtë:

1. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 1, 2, 8 dhe 9 lidhur me: (i) mënyrën e financimit të veprimtarisë së BMP; (ii) pavarësinë institucionale; (iii) transparenca dhe raportimi nuk janë në përputhje me parimet dhe shtyllat bazë të mbikëqyrjes publike që janë të parashikuara nga neni 29 i kapitullit VI “Sigurimi i Cilësisë” dhe neni 32 të kapitullit VIII “Mbikëqyrja Publike dhe Masat Rregullatore Ndërmjet Shteteve Anëtare” të Direktivës 2006/43/KE, teksti i konsoliduar. Parimi kryesor mbi të cilin detajohen edhe elementët kryesorë mbështetës të mbikëqyrjes së profesionit është caktimi i autoritetit rregullator, i cili ka përgjegjësinë përfundimtare për organizimin e një sistemi efektiv të mbikëqyrjes publike të profesionit të auditimit ligjor nëpërmjet mekanizmave si më poshtë:
 - a) Pavarësia institucionale e cila sigurohet nëpërmjet krijimit të autoritetit rregullator të pavarur dhe pavarësia nga profesioni e cila sigurohet nëpërmjet kritereve të përcaktuara për organin qeverisës të autoritetit, të cilët duhet të jenë jo praktikues dhe kritereve për shmangien e konfliktit të interesit, të parashikuara për strukturën mbështetëse që angazhohet në sigurimin e cilësisë të auditimit ligjor, si në Direktivën 2006/43/KE, ashtu edhe në ligjin për auditimin në zbatim.
 - b) Bazuar në ligjin nr. 10091 datë 05.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, anëtarët e BMP zgjidhen nga organe qendrore sipas propozimeve të parashikuara në këtë ligj, por kjo vjen për të krijuar një frymë kolegjiale decentralizuese e cila pas sjell vendimmarrje harmonike me praktikën më të mira ndërkombëtare. Pavarësia institucionale e BMP është në harmoni të plotë me direktivën e Bashkimit Evropian për auditimin dhe në përputhje me rregulloren 537/2014 të Bashkimit Evropian, gjë që është shprehur qartë edhe nga MF në relacionin ligjor të përgatitjes së ligjit të auditimit, lidhur me pavarësinë funksionale në marrjen e vendimeve dhe rregullimin e çdo aspekti të lidhur me profesionin e audituesit ligjor, pavarësinë financiare në mbledhjen dhe destinimin e të ardhurave të krijuara nga burimet e financimit të ndryshme nga buxheti i shtetit dhe pavarësinë organizative sipas të cilës

Bordit i është njohur e drejta për miratimin e strukturës së tij organizative. Në këtë kontekst, pavarësia financiare është ndër parimet bazë për funksionimin e sistemit të mbikëqyrjes publike, për të mundësuar angazhimin e individëve me njohuri të avancuara profesionale në çështjet e raportimit financiar, auditimit ligjor si edhe ekspertizë në dhënien e sigurisë për cilësinë e auditimit, të krahasueshme me profesionistët ushtrues. Vlen të theksohet, se ndryshimet e propozuara synojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, në lidhje me kuadrin e raportimit financiar mbi të cilat do të hartohen dhe do të auditohen pasqyrat financiare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Në lidhje me propozimin e ndryshimeve në projekt ligj, konkretisht pika 1 e nenit 4, ku shtohet togfjalëshi “person juridik publik” sqarojmë se referuar doktrinës së të drejtës administrative, BMP ka qenë në cilësinë e personit juridik edhe sipas ligjit në fuqi me nr. 10091/2009, i ndryshuar, për vetë karakteristikat që ka, ndër të cilat mund të përmenden funksioni rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e auditimit ligjor, autonomia juridike, administrative dhe financiare, parashikimi në ligj për nxjerrjen e aktit administrativ, etj. Në të njëjtën formë organizimi janë edhe autoritetet e tjera rregullatore e mbikëqyrëse të krijuara me ligj, të tilla si: KKK, AMF, AMA, etj.

Në kuptim të sa më sipër, BMP është organ publik në formën e personit juridik publik i krijuar me ligj, që ushtron kompetencat e mbikëqyrjes së profesionit të auditimit ligjor.

- c) Lidhur me përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator të fushës me *acquis communautaire*, realizimi i ndryshimeve të këtij ligji i përgjigjet kërkesave të paraqitura në Kapitullin 6 “Legjislacioni tregtar” të raportit të progresit të BE për vendin tonë, si dhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (2024–2026), të cilat kërkojnë harmonizimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për kontabilitetin, transparencën dhe auditimin ligjor me *acquis* më të fundit të BE-së duke theksuar forcimin e kapaciteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) përsa i përket burimeve njerëzore dhe financimit të këtij institucioni, forcimin e kërkesave për sistemin e sigurimit të cilësisë, si edhe forcimin e kuadrit ligjor lidhur me zbatimin e ligjit dhe masat shtrënguese përkatëse.
- d) Në lidhje me raportimin dhe transparencën e BMP, ligji në zbatim parashikon raportimin vjetor pranë Ministrit të Financave, si edhe publikimin e veprimtarisë vjetore, i cili realizohet në mënyrë të detajuar, ku përfshihet raportimi i financimit dhe përdorimit të burimeve, informacioni mbi vendimmarrjen e BMP, raportimi i mbikëqyrjes lidhur me kontrollat e kryera për sigurimin e cilësisë, mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe organizatave të kontabilistëve të miratuar, bashkëpunimet me institucione vendase dhe të huaja. Një rëndësi e madhe në këtë raportim, i kushtohet treguesve të cilësisë së auditimit, analizës së tregut të auditimit, rezultatet dhe rekomandimet e procesit të kontrollit të sigurimit të cilësisë të cilat shërbejnë si një burim informacioni jo vetëm për zhvillimin profesional të audituesve ligjorë, por edhe për vlerësimin e ndikimit të sistemit aktual të mbikëqyrjes në tregun e auditimit dhe në profesion. Nëpërmjet procesit të mbikëqyrjes synohet sigurimi i standardeve më të larta në cilësinë e auditimit, duke pasur në fokus të gjitha palët që mbështeten në një sistem të shëndoshë financiar. Në bazë të analizave nga raportimi vjetor, vitet e fundit është vënë re një përmirësim i ndjeshëm i punës së audituesve, në mënyrën e organizimit të punës dhe

kohës së angazhimit të tyre në misionet e auditimit, duke sjellë si rezultat dhe një përmirësim në cilësinë e raportimit financiar të njësive ekonomike. Ky angazhim i shtuar reflektohet dhe në rritjen e konsiderueshme të totalit të vlerës së tregut prej 60% që prej vitit 2018, si një nga treguesit e rëndësishëm lidhur me zhvillimin e profesionit dhe vlerësimin e punës së audituesve. Në këtë kontekst, çështjet e identifikuara në propozimin e paraqitur, lidhur me transparencën e vendimmarrjes, raportimit dhe publikimit, jo vetëm që janë të adresuara në ligjin në zbatim, por edhe me ndryshimet e propozuara është synuar rritja e mëtejshme e transparencës dhe përgjegjshmërisë të raportimit të veprimtarisë, në lidhje me kuadrin e raportimit financiar mbi të cilat do të hartohen dhe do të auditohen pasqyrat financiare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Ndërkohë, neni 32 i Direktivës 2006/43/KE në pikën 4 përcakton se:

“Autoriteti kompetent mbikëqyrës ka përgjegjësinë përfundimtare për mbikëqyrjen e:

- (a) miratimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;
- (b) miratimit të standardeve për etikën profesionale, kontrollin e brendshëm të cilësisë së shoqërive audituese, auditimit dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, përveç rasteve kur ato standarde janë miratuar ose aprovuar nga autoritete të tjera të Shteteve Anëtare;
- (c) edukimin e vijueshëm profesional;
- (d) sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë;
- (e) sistemin e investigimit dhe masave disiplinore dhe administrative”.

Në pikën 4b. të këtij neni parashikohet gjithashtu se:

“Shtetet Anëtare mund të delegojnë ose lejojnë autoritetin kompetent të delegojë ndonjë nga detyrat e tij autoriteteve ose organeve të tjera të përcaktuara ose ndryshe të autorizuar me ligj për të kryer këto detyra.

Në delegim specifikohen detyrat e deleguara dhe kushtet në të cilat ato do të kryhen. Autoritetet ose organet organizohen në një mënyrë të tillë që të shmangët konflikti i interesave. Kur autoriteti kompetent i delegon detyra autoriteteve ose organeve të tjera, ai do të mund të rimarrë kompetencat e deleguara rast pas rasti.”.

Siç është e parashikuar nga dispozita e direktivës më sipër, parimet e funksionimit të sistemit të mbikëqyrjes janë aktualisht pjesë e detyrave të BMP, sipas ligjit në zbatim të auditimit. Ndryshimet e propozuara nga MF në projektligjin për auditimin, synojnë përafrimin e mëtejshëm me kërkesat e direktivës në funksion të forcimit të sistemit të mbikëqyrjes së profesionit të auditimit, që adreson njëkohësisht një nga rekomandimet kryesore të progres raportit të KE.

2. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 3 dhe 4 të IEKA nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit 29 të Direktivës 2006/43/KE për sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë, nenin 26 të rregullores 537/2014 dhe njëkohësisht cenojnë pavarësinë e parashikuar në nenin 32 të kësaj direktive, të cilat përcaktojnë qartë se është autoriteti kompetent ai që realizon kontrollin e sigurimit të cilësisë. Bordi i Mbikëqyrjes Publike është autoriteti kompetent që realizon kontrollin e sigurimit të cilësisë sipas ligjit në zbatim të auditimit dhe kuadrit rregullator të BE lidhur me mbikëqyrjen e profesionit. Ky funksion mund të delegohet në përputhje me parimet e parashikuara në nenin 32 të Direktivës, për sigurimin e cilësisë për

audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të angazhuara në auditimin e njërive ekonomike jo me interes publik, sikurse parashikohet edhe në nenin 7 të projektligjit të propozuar nga MF. Në projektligjin e MF, propozimet për ndryshim, synojnë përafrimin e plotë në lidhje me sigurimin e cilësisë, si edhe forcimin e mjedisit rregullator me qëllimin rritjen e cilësisë së auditimit dhe raportimit financiar.

3. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 5 të IEKA, pranohet pjesërisht ndryshimi i propozuar lidhur me pikën 3 të nenin 17 të projektligjit të MF për nenin 37, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

3. Pika 2, ndryshon si më poshtë:

“2.Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë” (SNAS) janë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë (SNMC) dhe Standarde të tjera të lidhura me to, të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë (BSNAS), në masën që ato janë të rëndësishme për auditimin ligjor, të përkthyer dhe publikuara në gjuhën shqipe, jo më vonë se 12 muaj nga data e publikimit, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, nën përgjegjësinë e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP.”.

4. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 6 të IEKA, pranohet pjesërisht ndryshimi i propozuar lidhur me nenin 13 të projektligjit të MF:

Në nenin 32, pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1.Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit zbatojnë parimet e etikës profesionale, ku përfshihen të paktën funksioni i tyre me interes publik, integriteti, objektiviteti, aftësia profesionale dhe kujdesi i duhur, siç përcaktohet në kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës të Profesionistëve Kontabël të publikuar nga FNK, përkthyer dhe publikuar prej tyre në shqip nga organizata profesionale e audituesve ligjorë jo më vonë se 12 muaj nga data e publikimit dhe të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP.”.

Lidhur me heqjen e togfjalëshit “të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP” ndryshim i propozuar në pikën 5, 6 dhe 7 konstatohet se bie ndesh me kërkesat e nenit 32 të Direktivës lidhur me përgjegjësinë përfundimtare të autoritetit kompetent mbikëqyrës, si edhe analizuar më lart.

5. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 10 të IEKA, vlerësojmë që nuk janë të nevojshme, pasi projektligji për auditimin i MF i ka parashikuar në nenin 6 dhe 7. Megjithatë, arsytimi i paraqitur në këtë propozim se “Nevojat për rregullimin dhe vetërregullimin e IEKA’s shprehen në statut, dhe si rrjedhojë përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësi, të cilat janë të përcaktuara në ligjin referues për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri nuk janë të nevojshme të përsëriten në ligjin për auditimin” kërkon për rrjedhojë shfuqizimin tërësor të neneve 8, 9, 10, 11 dhe 13 të ligjit 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar dhe jo ndryshimin përkatës të parashikuar në propozimin 10, pasi këto ndryshime nuk janë në pajtueshmëri me parimet e mbikëqyrjes të parashikuara në direktivë dhe të sqaruar më lart.

6. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 12, janë çështje që rregullohen nga ligje të tjera në fuqi si edhe nuk janë në pajtim me kërkesat e kapitullit 4 të direktivës që parashikon dispozitat lidhur me etikën profesionale, konfliktin e interesit, pavarësinë, objektivitetin, konfidencialitetin dhe sekretin profesional.

7. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 13, nuk janë në pajtim me dispozitat e nenit 24b të direktivës, lidhur me organizimin e punës, i cili është transpozuar në ndryshimet e propozuara në projektligjin e MF.
8. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 14 janë të së njëjtës linjë me propozimet e draft-projektligjit, duke theksuar se çdo bashkim i përkohshëm, në kuptimin e legjislacionit tregtar kërkon krijimin e një personi juridik në formën e shoqërisë, sikurse është e paraqitur për ndryshim në propozimin e nenit 20 të projektligjit /2024 të MF, që përcakton: *“Të gjitha njësitë ekonomike të klasifikuara të mëdha dhe NJEIP, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, detyrohen ta kryejnë auditimin vetëm nëpërmjet shoqërive audituese.”*. Prandaj, vlerësojmë se është i panevojshëm përfshirja e konceptit të bashkimit të përkohshëm. Gjithashtu, vlerësojmë se është i panevojshëm ndryshimi i propozimit 14 në të cilin kërkohet të shtohet *“Të gjitha njësitë ekonomike të cilat plotësojnë të paktën një nga kushtet e përcaktuara në pikat i-iii, duhet të realizojnë shërbimin e rishikimit të pasqyrave financiare në përputhje me standardet.”*, pasi ky shërbim përfshihet në pikën 4/1 të nenit 33 të ligjit në zbatim 10091/2009, i ndryshuar dhe kushtëzimi i ofrimit të këtij shërbimi rrit kostot e biznesit.
9. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 14 pika 4 dhe propozimin 16 në lidhje me masat sanksionuese, bien ndesh me përgjegjësinë përfundimtare të autoritetit kompetent mbikëqyrës të parashikuar në kërkesat e nenit 32 të Direktivës, si edhe me dispozitat e parashikuara në kapitullin VII të direktivës për sistemin e investigimit dhe sanksioneve. Kështu, neni 30 i Direktivës 2006/43/KE, kërkon që autoriteti kompetent të zbatojë një sistem efikas të investigimit dhe masave sanksionuese. Në këtë kontekst masat sanksionuese të propozuara në nenin 24 dhe 25 të projektligjit /2024 dhe aktet nënligjore që do të hartohen kanë për qëllim garantimin e zbatimit të parimit të sigurimit të hapave të nevojshëm për korrigjimin e situatës dhe të proporcionalitetit, në përputhje me shkeljet e konstatuara. Prandaj, pjesërisht ndryshimet e parashikuara në propozimin 15 si në vijim:
“Në nenin 24, pas pikës 3, shtohet pika 4, me përmbajtje si më poshtë vijon:
“4. Për qëllime të pikës 3 të këtij neni, reputacioni i mirë i një audituesi ligjor ose shoqërie audituese mund të konsiderohet si i dëmtuar ndjeshëm, por pa u kufizuar, në situatat e mëposhtme:
a) është marrë një vendim gjyqësor i formës së prerë që përfshin heqjen ose kufizimin e lirisë gjatë procedimit penal për një vepër të kryer me dashje në fushën e auditimit ligjor dhe për të cilin ekziston një masë ndalim për ushtrim të profesionit me vendim gjyqësor;
b) është objekt i masës ndaluese që i ka ndaluar ushtrimin e profesionit të audituesit ligjor;
c) është vendosur një sanksion disiplinor ose administrativ nga institucione të tjera Shqiptare ose të huaja për shkelje profesionale në mënyrë të rëndë dhe të përsëritur;
ç) ka shkelur rëndë ose në mënyrë të përsëritur kodin e etikës, rregullat e moralit dhe të profesionit, rekomandimet e autoriteteve mbikëqyrëse të profesionit apo të autoriteteve të ndryshme mbikëqyrëse të tregut.”
10. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 17 të IEKA, në lidhje me emërimin për një periudhë kohore prej tre vjetësh, janë në kundërshtim me kërkesat e direktivës dhe rregullores 537/2014 në lidhje me emërimin e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese. Gjithashtu, propozimi për ndryshim lidhur me uljen nga 3(tre) vite në 1(një) vit të kohëzgjatjen që duhet

të kalojë zëvendësimi i audituesit ligjor ose shoqërisë audituese është në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të rregullores 537/2014.

Përsa i përket propozimit për të shtuar pikën 5 në nenin 21 të projektligjit _/2024 vlerësohet të pranohet formulimi si në vijim:

“ 5. Në rast të mos zbatimit të dispozitave të këtij neni nga audituesit dhe shoqëritë e auditimit do të zbatohen masat sanksionuese në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

6. Në rast të mos zbatimit të dispozitave të këtij neni nga organi administrativ ose drejtues i një njësie ekonomike me interes publik do të zbatohen masat sanksionuese të parashikuara në nenin 55 të këtij ligji.”.

11. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 18 të IEKA, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 39, për komitetin e auditimit, të direktivës 2006/43/KE dhe kërkesat për raportim të rregullores 537/2014.
12. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 19 të IEKA, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 8 të rregullores 537/2014 dhe me parimet e nenit 24b dhe nenit 29 të direktivës 2006/43/KE, në lidhje me sigurimin e cilësisë dhe sistemin e brendshëm të kontrollit të cilësisë të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese.
13. Ndryshimet e parashikuara në propozimin 20 të IEKA, janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 8 lidhur me disiplinat për të cilat duhet të testohen kandidatët për marrjen e titullit profesional dhe nenin 10 të direktivës 2006/43/KE, lidhur me praktikën profesionale dhe hyrjen në profesion.
14. Sugjerimi në lidhje me përcaktimin e kriterëve shtesë për shoqëritë audituese që do të auditojnë NJEIP dhe njësitë ekonomike të mëdha është reflektuar.

Në lidhje me mendimet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike dërguar nëpërmjet shkresës nr.159, datë 11.07.2024 si dhe bazuar në takimin konsultativ, japim sqarimet si më poshtë:

1. Sugjerimi në lidhje me zvogëlimin e numrit të viteve të përvojës për inspektorët e cilësisë si dhe eksperiencën në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë u reflektua.
2. Sugjerimi në lidhje me financimin e BMP, nëpërmjet pagesës së marrë ndaj auditimeve të njëjësive jo me interes publik, u reflektua.
3. Përsa i përket sugjerimeve mbi shfuqizimin e neneve mbi organizimin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe në lidhje me statutin e saj, ju sqarojmë se mënyra e organizimit institucional të palëve të përfshira në këtë fushë është jashtë qëllimit të amendimeve aktuale të projektligjit (nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE në këtë fushë), të cilat janë paraqitur në seksionet më lart të relacionit. Organizimi bazë i këtyre organeve jepet në ligj, ndërkohë statuti i organizatës do të detajojë më shumë rregullat mbi funksionimin dhe organizimin e saj.
4. Përsa i përket sugjerimit mbi përcaktimin e kriterëve shtesë ju sqarojmë se vendosja e këtyre kriterëve dëmton konkurrencën dhe krijon një lloj pabarazie në tregun e auditimit ligjor. Për shkak të rëndësisë dhe impaktit të kanë NJEIP në treg, audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit duhet të kenë kapacitetet e duhura njerëzore dhe profesionale për të përmbushur këtë detyrë me integritetin dhe saktësinë e duhur. Gjithsesi, kriteret më specifike, vendosen nga vetë njësitë që do auditohen, në varësi të mënyrës së organizimit të tyre.
5. Sugjerimi në lidhje me raportimin në komitetin e auditimit u reflektua.

6. Sugjerimi në lidhje me nenin 54 dhe 55 të ligjit të auditimit ligjor u reflektua.

Pas reflektimit të mendimeve/komenteve të mësipërme, projektligji është ridërguar për bashkërendim pranë Minsitrisë së Drejtësisë si dhe pranë Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit (për pjesën e përputhshmërisë me legjislacionin e BE) si më poshtë:

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori

1. Në lidhje me formatimin dhe përgatitjen e tabelave të përputhshmërisë, në të dyja gjuhët, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori ka shprehur dakordësinë për të vijuar më tej me procedurat e miratimit të këtij projektligji.

Ministria e Drejtësisë

1. Përsa i përket togfjalëshit “apo ku është e zbatueshme”, për të cilin është dhënë shpjegimi më lart, komenti është reflektuar, duke shtuar togfjalëshin “sipas kërkesave të legjislacionit përkatës në fuqi”. Gjithashtu, ritheksojmë se ky përkufizim është në është në përputhje me përkufizimin e këtij termi në Direktivën e BE në lidhje me fushën e auditimit ligjor, ndaj është i kuptueshëm si term i kësaj fushe.
2. Përsa i përket sugjerimit në lidhje me vendosjen e gjobave, komenti është reflektuar në projektligj.
3. Përsa i përket komentit në lidhje me shpjegimin e termit “njësi ekonomike jo me interes publik”, është dhënë sqarimi më lart në relacion, në pikën 5 të mendimeve të ardhura gjatë fazës së parë të bashkërendimit me Ministrinë e Drejtësisë.
4. Sugjerimi në lidhje me përdorimin e foljes “mund” dhe lidhëzës “dhe/ose” është reflektuar, për aq sa është e mundur në këtë projektligj. Ritheksojmë se ndryshimet kryesore të projektligjit janë në përputhshmërisë të plotë me Direktivën dhe Rregulloren e BE, ndaj dhe përdorimi i foljes “mund” dhe lidhëzave “dhe/ose” është realizuar në përputhje me kontekstin e fushës së auditimit ligjor.
5. Sugjerimi në lidhje me përkufizimin e “skepticismit profesional” është reflektuar.
6. Në lidhje me përcaktimin e afateve mbi procedurat e sigurimit të cilësisë, ju risqarojmë se këto afate të lidhura me raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë, si një nga elementët kryesorë të mekanizmit të mbikëqyrjes nga ana e BMP, janë në përputhje të plotë me praktikat më të mirat ndërkombëtare, konkretisht me pikën 8 të nenit 26 në Rregulloren e BE mbi auditimin ligjor nr. 537/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e ndryshuar, si dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit 18 të Rregullores të BMP nr. 7, datë 02.10.2018 “Për Procedurat, metodologjinë dhe organizimin e Kontrollit të Cilësisë së Auditimit Ligjor”, e ndryshuar. Gjithashtu, dhe Kodi i Procedurave Administrative lejon që në ligje të posaçme të përcaktohen afate kohore për çështje specifike të fushës, siç është dhe rasti i projektligjit të auditimit ligjor, të cilat përfrojnë legjislacionin përkatës të BE.
7. Në lidhje me sugjerimin mbi nenin 20 të projektligjit, sqarojmë së në kuadër të kuptueshmërisë më të madhe, duke qenë se kriteret për kryerjen e auditimit ligjor lidhen me tejkalimin e dy prej tre treguesve të përcaktuar, vlerësojmë që do ishte një paraqitje më e mirë nëse do lihen të tre kriteret në projektligj.

8. Përsa i përket komentit në lidhje me sanksionet që ndërmerren nga BMP, ju risqarojmë ky nen është hartuar në mbështetje të nenit 30 të Direktivës së BE në lidhje me fushën e auditimit ligjor. Në pikën 2 të këtij neni janë përcaktuar llojet e sanksioneve të zbatueshme në përputhje me rastet e parashikuara në rast të mos zbatimit të kërkesave përkatëse të ligjit, sipas parashikimeve të paraqitura në pikat 3-5, pra kemi një masë sanksionuese në varësi të shkeljeve që është konstatuar në subjekt. Këto masa sanksionuese do të garantojnë zbatimin proporcional në përputhje me shkeljet e konstatuara, të cilat do të detajohen nëpërmjet rregulloreve përkatëse, që do të hartohen nga BMP në zbatim të pikës 6 të këtij neni.
9. Përsa i përket sugjerimit mbi paraqitjen e procesit të ankimimit dhe institutit të rishikimit, theksojmë se ndarja e tyre është reflektuar bazuar në sugjerimin e dhënë nga ana juaj gjatë fazës së parë të procesit të bashkërendimit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekt-ligji nuk ka implikime financiare shtesë në buxhetit e shtetit.

MINISTRI I FINANCAVE

ERVIN METE